



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE E PAJISJEVE MJEKËSORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[Data: 31/05/2024]

Drejtuar: **“KRIJON” sh.p.k.**, me adresë: Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak 1044, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar–Mallra–Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Blerje reagentë, qelqurina dhe materiale të tjera për Laboratorin e Kontrollit”*, me fond limit 6,014,800 (gjashtë milion e katërbëdhjetë mijë e tetëqind) Lekë pa TVSH, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj, Procedurë e Hapur e Thjeshtuar–Mallra–Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-99379-03-26-2024

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.27 datë 27.05.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. **“ALBUJI” sh.p.k.**

Emri i plotë i shoqërisë

K64112206J

Numri i NIPT-t

Vlera: *“nuk ka”*

2. **“ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” sh.p.k.**

Emri i plotë i shoqërisë

L51512009E

Numri i NIPT-t

Vlera: *“nuk ka”*

3. **“GAMMA” sh.p.k.**

Emri i plotë i shoqërisë

K31510153H

Numri i NIPT-t

Vlera: 239,203,350 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë (pa TVSH).

4. **“KRIJON” sh.p.k.**
Emri i plotë i shoqërisë

K12023001A
Numri i NIPT-t

Vlera: 4,522,000 (katër milion e pesëqind e njëzet e dy mijë) lekë (pa TVSH).

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. **“GAMMA” sh.p.k.**
Emri i plotë i shoqërisë

K31510153H
Numri i NIPT-t

Vlera: 239,203,350 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë (pa TVSH).

Arsyet e mëposhtme:

“Në zbatim të Nenit 92/2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar ku përcaktohet shprehimisht se:

“Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.”-

Nenit 82, pika 3/a, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se:

“3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.”-

Vlera e korrigjuar dhe e konfirmuar nga ana juaj më datë 21.5.2024, ora 10.04 AM sipas Formularit të Ofertës-Shtojca 1, dhe Lista e Çmimeve të Artikujve-Shtojca 2, të njoftuar elektronikisht nga ana juaj në SPE, nuk është në vlerën e korrigjuar nga AK sipas njoftimit elektronik të datës 20.5.2024 ora 16.14PM, ku shprehimisht thuhet se:

“Në përputhje me rregullin e përcaktuar në nenin 82, pika 3/a të RPP-së, KVO ka bërë korrigjimin e gabimeve aritmetike duke bërë shumëzimin e sasisë së kërkuar për artikujt me nr.rendor 1 deri në 75, me çmimin për njësi të deklaruar nga ana e OE në ofertën e dorëzuar e mbi këtë bazë korrigjimin e çmimi total si vijon:

(e) Çmimi total i Ofertës, pa TVSH, është: 239,203,350 [dyqind e tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tremijë e treqind e pesëdhjetë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 287,044,020 [dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyzetë e katër mijë e njëzetë];

Bashkëlidhur në tabelë do të gjeni listën e çmimeve të artikujve të korrigjuar.”-

Ju keni deklaruar: Çmimin total të Ofertës në shumën: 4,696,000(katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë)lekë pa TVSH; 5,635,200 (pesë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind)lekë me TVSH, për shkak se:

“Keni ndryshuar “çmimin për njësi” të artikujve me numër rendor nga nr.1 deri në nr.75” - si e tillë oferta juaj refuzohet automatikisht”

2. **“ALBUJI” sh.p.k.**
Emri i plotë i shoqërisë

K64112206J
Numri i NIPT-t

Vlera: “nuk ka”

Arsyet e mëposhtme:

“Oferta juaj refuzohet për arsye se: **nuk keni përmbushur kriteret e përcaktuara në DST.**
Në dokumentacionin e dorëzuar nga ana juaj në SPE i përgjigjen kërkesave të përcaktuara në Shtojcën 7, pika 2.1 dhe pika 2.3 gërma “c”, **vetëm** dokumentet si vijon:

- Diplomë “Master i Shkencave në Kimi industriale e mjedisore” për zj.Arjola Ismalaj me Nr.2837, datë lëshimi 30.8.2020 i FSHN;
- Certifikatë ISO 9001: 2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” të lëshuar nga trupa akredituese AQSCERT me Nr.AQS/Q/101492023, e vlefshme deri më datë 17.4.2026.

Dokumenti i dorëzuar nga ana juaj: Sigurimi i Ofertës, sipas **Shtojcës 3**-lëshuar nga Shoqëria e Sigurimeve EUROSIG sh.a. me Nr.serial 060322020057050, në vlerën 144,355.20lekë, lëshuar më datë 9.5.2024 **nuk plotëson** afatin e kërkuar sipas njoftimit të kontratës, të vlefshmërisë së ofertës 150 ditë (që fillon nga momenti i hapjes së ofertave më datë 13.5.2024)”

3. **“ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” sh.p.k.**
Emri i plotë i shoqërisë

L51512009E
Numri i NIPT-t

Vlera: “nuk ka”

Arsyet e mëposhtme:

“Oferta juaj refuzohet për arsye se **nuk keni përmbushur asnjë nga kriteret e përcaktuara në DST.**
Nuk rezulton të keni dorëzuar asnjë nga dokumentet e kërkuara në DST”

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. **“KRIJON” sh.p.k.**
Emri i plotë i shoqërisë

K12023001A
Numri i NIPT-t

Vlera: 4,522,000 (katër milion e pesëqind e njëzet e dy mijë) lekë (pa TVSH).

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, brenda 5 ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Blerina KAZA